

V E N D I M
Nr.79, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi	Anëtar i	“““
Kujtim Puto	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi	Anëtar i	“““
Tefta Zaka	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 16.7.2001. mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.97 Aktin që i përket:

Kërkues: Pëllumb Vladi, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

Subjekte të interesuarA:

1. Komisioni Qendror i zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sokol Lamaj
2. Ibrahim Bruka

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.158, datë 10.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit nr. 158, datë 10.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka parashtruar këto shkaqe:

- Vulat e disa qendrave të votimit në Bërxullë dhe Paskuqan janë dorëzuar në Komisionin e Zonës Zgjedhore jashtë kutisë, ndërsa një kuti votimi ka qenë e hapur.
- Në tre qendra votimi në Paskuqan dhe Bërxullë janë zhdukur 964 fletë votimi.
- Në tre qendra votimi janë lejuar të nënshkruajnë procesverbalet komisionerë të jashtëligjshëm.
- Në disa qendra votimi në Zall-Herr dhe Paskuqan janë penguar të votojnë mbi 600 ushtarë dhe rreth 800 zgjedhës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.44, me vendimin nr.6, datë 9.7.2001, ka shpallur deputet të drejtpërdrejtë në këtë zonë Ibrahim Bruka. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.158, datë 10.7.2001, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.44, duke e njohur këtë kandidat si fitues.

Të gjitha shkeljet që pretendohen nga kërkuesi i referohen raundit të dytë të zgjedhjeve të zhvilluar më datën 8.7.2001. Sipas tabelës së rezultateve të këtij raundi zgjedhjesh, të pasqyruar në modelin 39/1, rezulton se kërkuesi ka marrë 4 537 vota kundrejt fituesit që ka marrë 6 064 vota.

Nga provat e administruara të cilat ndodhen në dosjen gjyqësore, Gjykata Kushtetuese çmon se shkeljet e konstatuara nuk janë të tilla që të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në

këtë zonë. Një pjesë e pretendimeve për shkelje të parashtruara nga kërkuesi nuk u provuan, pasi sipas ligjit, edhe barra e të provuarit i përket atij që e pretendon. U pretendua se kutia e votimit e qendrës nr.2 Bërxullë ka ardhur në Komisionin e Zonës Zgjedhore e hapur, ndërsa në disa qendra të tjera, vulat e njoma kanë qenë jashtë kutive të votimit. Këto pretendime jo vetëm që nuk u provuan përpara gjykatës me prova, por edhe nëse do të ekzistonin si shkelje, përderisa kërkuesi nuk i konteston si të pavërteta rezultatet e pasqyruara në procesverbalet e këtyre qendrave të votimit, një kopje të të cilave ai e ka administruar, atëherë ato mbeten të papranueshme.

Edhe lidhur me pretendimin për zhdukjen e 940 fletëvotimeve në qendrën e votimit nr.12 të Komunës së Paskuqanit, të cilat nuk rakordojnë me të dhënat e procesverbalit, kërkuesi duhej të provonte përpara gjykatës se këto fletëvotime janë përdorur në disfavor të tij në ndonjë qendër tjetër votimi brenda kësaj zone zgjedhore, duke ndikuar padrejtësisht në rezultat. Përfaqësuesi i zotit Brahim Bruka, lidhur me këtë pretendim të kërkuesit, paraqiti në seancë gjyqësore procesverbalin e kësaj qendre votimi në të cilën nuk rezultoi një mangësi e tillë në fletët e marra në dorëzim, por vihet re mosplotësim në disa ekstremite të procesverbalit, që ka sjellë mosevidentimin e saktë të sasive të fletëvotimeve.

Lidhur me nënshkrimin në procesverbalet e tre qendrave të votimit të tre personave të cilët nuk ishin emëruar si anëtar komisioni, Gjykata Kushtetuese konkludon se, pavarësisht se ata kanë qenë me cilësinë e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore përkatëse, nënshkrimi i tyre si komisionerë përbën shkelje të ligjit. Megjithatë duke vlerësuar se kjo shkelje ligjore, në kuptim dhe të nenit 113 pika 1 shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, nuk është e një natyre të tillë që të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatin e ndjeshëm midis dy kandidatëve, ajo mbetet për t’u evidentuar si parregullsi, e cila nuk e bën cenueshëm vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pretendimi tjetër i kërkuesit për mohimin e të drejtës për të votuar të rreth 800 zgjedhësve, si dhe pengimin e 600 ushtarëve për të votuar me librezë ushtarake nuk u shoqërua me asnjë provë për t’i krijuar bindje gjykatës për vërtetësinë e parregullsive të tilla.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa nuk gjen mbështetje në prova dhe në ligj dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.